

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 588 Prot.

Tiranë, më 03 . 06 2016

**VENDIM Nr. 51, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor në vazhdim "Apolonia"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Faik Drini (IA) dhe Prof. Jean Luc Lamboley,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor në vazhdim "Apolonia"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Faik Drini (IA) dhe Prof. Jean Luc Lamboley, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Vazhdimin e gërmimeve në sektorin G, me qëllim zbulimin e kompleksit të rrugës jugore të banesës romake.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë gusht 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

